


Tregtia e jashtme e mallrave

Tetor 2024

Tiranë, më 18 Nëntor 2024: Në Tetor 2024 eksportet e mallrave arritën vlerën 31 mld lekë, duke u ulur me -15,2 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe duke u rritur me 0,9 %, në krahasim me Shtator 2024. Importet e mallrave arritën vlerën 77 mld lekë, duke u ulur me -1,5 %, në krahasim me një vit më parë dhe duke u rritur me 8,3 %, në krahasim me Shtator 2024. Defiçiti tregtar i këtij muaji është 46 mld lekë, duke u rritur me 10,6 %, krahasuar me Tetor 2023 dhe duke u rritur me 13,9 %, në krahasim me Shtator 2024.

Fig.1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)




Në këtë dhjetëmujor eksportet e mallrave arritën vlerën 317 mld lekë, duke u ulur me -14,3 %, krahasuar me një vit më parë, ndërkohë importet e mallrave arritën vlerën 743 mld lekë, duke u rritur me 2,0 %, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 426 mld lekë, duke u rritur me 18,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2023.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:

Gjatë muajit Tetor 2024, në uljen e eksporteve prej -15,2 %, kanë ndikuar grupet: “Materiale ndërtimi dhe metale” me -8,2 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -3,5 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -2,9 pikë përqindje etj.

Për publikim 18/11/2024

Fig.2 Kontributi i grupevenë ndryshimin vjetor të eksporteve, Tetor 2024




Eksportet, gjatë këtij dhjetëmujori janë ulur me -14,3 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar negativisht në uljen vjetore të eksporteve, janë: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -5,6 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -5,0 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -2,2 pikë përqindje.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:

Gjatë muajit Tetor 2024, në uljen e importeve prej -1,5 %, krahasuar me Tetor 2023, negativisht kanë ndikuar grupet: “Materiale ndërtimi dhe metale” me -3,3 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -1,0 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -0,8 pikë përqindje, etj. Ndërsa pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +2,8 pikë përqindje, “Ushqime, pije, duhan” me +0,7 pikë përqindje.

Fig.3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Tetor 2024



Si dhjetëmujor, importet janë rritur me 2,0 %, krahasuar me dhjetëmujorin e parë 2023. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të importeve, janë: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +2,7 pikë përqindje, “Ushqime, pije, duhan” me +1,2 pikë përqindje, etj. Ndërsa kanë ndikuar negativisht grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -1,2 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -0,9 pikë përqindje, “Lëkurë dhe artikujt prej tyre” me -0,3 pikë përqindje.

Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere


Në muajin Tetor 2024, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur ulje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Tetor 2023 janë: Kosova (24,0 %), Italia (13,6 %), Spanjë (4,7 %), etj. Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur rritje më të madhe, janë:Greqia (12,3 %), Gjermania (11,4 %).

Gjatë këtij dhjetëmujori vendet me të cilët Shqipëria ka pasur ulje më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Greqia (20,2 %), Italia (14,2 %), Kosova (8,5 %), etj. Ndërsa vendet me të cilin eksportet kanë pasur rritjen më të madhe, është: SHBA (68,3 %), Kina (16,8 %), etj.

Në muajin Tetor 2024, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur uljen më të madhe te importeve, janë: Maqedonia Veriut (17,6 %), Italia (3,4 %), etj. Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur rritjen më të madhe të importeve, në krahasim me Shtator 2023 janë: Greqia (28,1 %), Turqia (6,6 %), Kina (2,7 %), etj.

Gjatë këtij dhjetëmujori , vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritjen më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Greqia (19,9 %), Turqia (16,3 %), Kina (0,2 %), etj. Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Maqedonia e Veriut (14,5 %), Italia (3,2 %), Spanja (2,0 %), etj.

Fig.4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Tetor 2024



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE-së zënë 60,3 %, të gjithë tregtisë, Në Tetor 2024, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 75,7 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 54,1 % të importeve gjithsej.

Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (29,4 %), Kina (8,6 %), Turqia (8,3 %) dhe Greqia (7,4 %).

Shkëmbimet tregtare, për dhjetëmujorin e parë 2024, me vendet e BE-së zënë 57,6 % të gjithë tregtisë, Në periudhën Janar – Tetor 2024, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 71,4 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 51,6 % të importeve gjithsej.

Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (28,0 %), Kina (8,3 %), Turqia (8,1 %) dhe Greqia (7,2 %).

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave, Tetor 2024

Vitet	Muajt	Eksporte (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar (mld lekë)	Mbulimi (%)
2000		37	-23.5	157	-1.5	-120	23.6
2001		44	19.1	190	21.0	-146	23.2
2002		47	7.7	210	10.6	-163	22.6
2003		54	14.7	226	7.4	-172	24.1
2004		62	14.0	236	4.5	-174	26.3
2005		66	6.0	262	11.1	-196	25.1
2006		77	17.6	299	14.1	-222	25.9
2007		97	25.5	376	25.8	-279	25.8
2008		113	15.8	440	16.9	-327	25.6
2009		105	-7.2	429	-2.5	-324	24.4
2010		162	54.6	478	11.4	-316	33.8
2011		197	21.9	544	13.9	-347	36.2
2012		213	8.2	528	-2.9	-315	40.3
2013		246	15.7	517	-2.1	-271	47.6
2014		256	3.8	552	6.7	-296	46.3
2015		243	-4.9	545	-1.4	-302	44.7
2016		243	0.1	579	6.4	-336	42.0
2017		273	12.1	626	8.1	-353	43.6
2018		310	13.7	641	2.4	-331	48.4
2019		299	-3.8	649	1.2	-350	46.0
2020		272	-9.0	605	-6.8	-333	44.9
2021		369	35.6	801	32.3	-432	46.1
2022		487	32.0	950	18.7	-464	51.2
2023		440	-9.5	873	-8.2	-432	50.5
2021	01 - 21	24	3.1	45	8.4	-22	52.3
	02 - 21	25	-0.9	52	0.9	-27	47.4
	03 - 21	32	78.1	64	45.3	-33	49.2
	04 - 21	29	92.3	63	72.9	-34	45.6
	05 - 21	33	52.7	62	38.4	-29	53.0
	06 - 21	35	50.8	67	28.9	-32	51.9
	07 - 21	32	30.6	72	26.1	-39	44.8
	08 - 21	24	22.5	61	26.2	-37	39.0
	09 - 21	33	31.1	69	31.6	-36	48.0
	10 - 21	34	26.3	77	29.2	-43	44.3
	Janar - Tetor 21	292	31.7	616	26.2	-324	47.4
2022	01 - 22	35	47.5	55	21.1	-20	63.6
	02 - 22	37	50.5	69	31.5	-31	54.3
	03 - 22	48	50.4	84	29.7	-36	57.1
	04 - 22	42	46.6	78	23.7	-36	54.0
	05 - 22	45	36.8	80	28.6	-35	56.4
	06 - 22	46	32.2	81	20.8	-35	56.8
	07 - 22	39	23.0	82	14.1	-42	48.3
	08 - 22	35	48.1	80	30.8	-44	44.2
	09 - 22	39	16.3	88	27.4	-49	43.8
	10 - 22	38	12.5	83	8.6	-45	45.9
	Janar - Tetor 22	404	38.6	778	26.4	-374	52.0
2023	01 - 23	42	20.2	58	5.8	-16	72.3
	02 - 23	38	2.8	69	1.1	-31	55.2
	03 - 23	42	-11.7	81	-3.7	-38	52.3
	04 - 23	34	-19.2	75	-3.9	-41	45.4
	05 - 23	40	-11.7	81	1.2	-41	49.2
	06 - 23	38	-17.3	75	-7.5	-37	50.7
	07 - 23	38	-4.0	71	-13.6	-33	53.7
	08 - 23	27	-21.9	68	-15.0	-40	40.6
	09 - 23	34	-12.8	73	-16.6	-40	45.8
	10 - 23	37	-4.3	78	-6.3	-42	46.8
	Janar - Tetor 23	370	-8.6	728	-6.4	-358	50.8
2024	01-24	30	-29.2	60	3.4	-30	49.5
	02-24	32	-16.1	74	6.4	-42	43.5
	03-24	33	-21.0	75	-7.0	-42	44.4
	04-24	35	1.8	75	0.6	-41	45.9
	05-24	35	-12.4	79	-1.6	-45	43.8
	06-24	35	-8.9	77	2.1	-42	45.3
	07-24	33	-12.0	85	21.1	-52	39.0
	08-24	22	-18.2	69	1.9	-46	32.6
	09-24	31	-8.5	71	-3.1	-40	43.3
	10 - 24	31	-15.2	77	-1.5	-46	40.3
	Janar - Tetor 24	317	-14.3	743	2.0	-426	42.7

Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë), Tetor 2024

	Eksporte				Importe			
	Tetor 2023	Tetor 2024	Jan.- Tet. 2023	Jan.- Tet. 2023	Tetor 2023	Tetor 2024	Jan.- Tet. 2023	Jan.- Tet. 2023
Vendet e BE-së	26.215	23.472	269.118	226.219	39.584	41.591	371.97	383.447
Austri	580	283	3.815	2.089	632	567	6.868	6.582
Gjermani	1.744	1.942	19.691	18.356	5.604	5.865	51.063	53.276
Greqi	1.763	1.980	24.636	19.652	4.722	6.050	47.533	57.004
Itali	16.669	14.407	161.317	138.447	17.938	17.330	162.809	157.648
Spanjë	1.221	1.164	15.832	10.894	1.107	1.217	11.385	11.158
Kroaci	231	243	4.008	3.356	1.044	456	7.664	4.243
Të tjera të BE-së	4.006	3.453	39.818	33.425	8.537	10.107	84.648	93.535
Mbretëri e Bashkuar	168	157	6.155	1.263	790	748	7.103	8.009
Kinë	1.097	829	7.900	9.226	8.207	8.427	78.164	78.335
Kosovë	3.530	2.683	34.694	31.761	1.022	1.263	9.553	13.417
Maqedonia e Veriut	1.092	639	14.367	10.405	1.104	909	11.521	9.846
Rusi	-	-	8	7	241	474	3.718	3.335
SHBA	450	347	3.682	6.196	1.363	1.960	14.470	16.760
Turqi	1.338	575	4.427	3.611	7.826	8.344	70.513	81.998
Ukrainë	6	212	1.051	2.932	573	234	3.512	3.377
Zvicër	166	87	3.961	1.941	966	1.339	11.546	7.992
Të tjera	2.489	1.992	24.440	23.242	16.380	11.592	146.228	136.008
Gjithsej	36.551	30.992	369.803	316.803	78.056	76.881	728.298	742.526

Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë), Tetor 2024

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Tetor 2023	Tetor 2024	Jan.- Tet. 2023	Jan.- Tet. 2024	Tetor 2023	Tetor 2024	Jan.- Tet 2023	Jan.- Tet. 2024
Gjithsej	36.551	30.992	369.803	316.803	78.056	76.881	728.298	742.525
Ushqime, pije, duhan	4.571	4.489	46.340	43.050	12.978	13.547	121.596	130.613
Minerale, lëndë djegëse, en, el,	6.784	5.738	81.837	60.961	8.636	7.850	85.651	76.946
Produkte kimike dhe plastike	1.494	1.280	13.188	13.121	10.268	10.234	96.053	96.353
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	190	186	2.268	1.697	1.245	1.015	11.775	9.811
Prodhime druri dhe letre	971	912	9.440	8.357	2.507	2.555	24.953	24.814
Tekstile dhe këpucë	10.782	9.504	106.813	88.499	8.834	8.194	78.803	72.209
Materiale ndërtimi dhe metale	7.467	4.474	66.536	58.502	12.144	9.581	102.678	101.887
Makineri, pajisje dhe pj, këmb,	3.413	3.382	33.377	31.599	17.768	19.946	176.341	196.134
Të tjera	879	1.027	10.003	11.017	3.676	3.960	30.447	33.758

Tab. 4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë), Tetor 2024

	Itali		Kosova		Greqi		Gjermani	
	2023	2024	2023	2024	2023	2024	2023	2024
Gjithsej	161.317	138.447	34.694	31.761	24.636	19.652	19.691	18.356
Ushqim, pije duhan	12.789	11.650	5.496	5.210	3.926	3.573	1.703	1.601
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	8.978	11.550	6.928	7.589	8.012	2.706	6.447	5.064
Produkte kimike dhe plastike	5.060	4.839	3.444	3.502	908	795	43	61
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	2.095	1.469	8	6	54	148	11	1
Prodhime druri dhe letre	5.477	4.359	1.025	1.035	1.483	1.310	107	109
Tekstile dhe këpucë	82.996	66.398	185	141	5.831	6.700	8.154	7.612
Materiale ndërtimi dhe metale	21.318	18.055	14.369	11.439	3.474	3.566	1.327	883
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	18.043	15.748	1.853	1.696	128	199	1.629	2.659
Të tjera	4.561	4.379	1.387	1.144	821	655	270	366

Tab. 5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë), Tetor 2024

	Itali		Kinë		Turqi		Greqi	
	2023	2024	2023	2024	2023	2024	2023	2024
Gjithsej	162.809	157.648	78.164	78.335	70.513	81.998	47.533	57.004
Ushqim, pije duhan	24.204	26.776	1.549	1.447	4.950	4.549	14.597	15.907
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	5.713	3.753	36	17	8.239	9.309	5.080	9.671
Produkte kimike dhe plastike	19.718	19.339	6.956	6.459	9.916	10.206	8.022	9.295
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	9.486	7.526	754	840	277	301	50	131
Prodhime druri dhe letre	5.653	5.058	1.703	1.742	3.835	3.904	3.333	3.348
Tekstile dhe këpucë	36.153	30.030	11.164	11.957	11.862	10.007	4.504	5.237
Materiale ndërtimi dhe metale	20.913	18.325	11.537	10.421	17.618	24.770	7.047	7.753
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	33.965	37.008	38.403	38.485	10.319	15.401	3.333	3.691
Të tjera	7.004	9.833	6.062	6.967	3.496	3.550	1.566	1.969

Metodologjia

Tregtia e Jashtme e mallrave është një publikim periodik mujor që paraqet tregtinë e mallrave të Shqipërisë me vendet e tjera të botës. Të dhënat e përpunuara nga INSTAT për këtë publikim janë të dhëna administrative të cilat merren nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Definicionet

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejitimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituan, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri